

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË " PMR Albania Consulting " SH.P.K.**

Sot, me datë 20/09/2024

GURTEN PAPULI, shtetas Shqiptar, lindur më 21/05/1986 në Tirane, Shqiperi, mbajtës i pasaportes me nr BB0550550 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**PMR Albania Consulting**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**PMR Albania Consulting**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Tirane, adresën: **Rruga Ukraina e Lire, pallati 16, Hyrja 1, kati 9 Tirane Shqiperi.**

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.


NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Sherbime Marketingu dhe telemarketingu, Sherbime ndermjetesimi biznesi, PR marrdhenie me publikun. Konsulence financiare, ndermetesimin, IT dhe inovacion, menaxhim Burimesh njerezore Konsulence ne fushen juridike, ekonomike, financiare, per sektorin publik si dhe per zhvillim biznesi dhe investimi me persona juridike vendas dhe te huaj. Projektim, zhvillim, dhe mirembajtje e sistemeve te informacionit dhe programeve kompjuerike te cdo kategorie. Krijim, kontroll dhe implementim te standarteve financiare dhe operacionale per institucione publike. Sherbime te teknologjise se informacionit, perpunim i te dhenave dhe analiza e tyre, kerkim dhe zhvillim ne sistemet inteligjente, ngritje e sistemeve te monitorimit dhe konsulence ne procedurat operacionale dhe administrative per menaxhimin e sistemeve te informacionit. Pervec ketyre, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperm.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe



të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100.000 Lek dhe është i ndarë në 1 kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Gurten Papuli** zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100,000 Lek dhe 100,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Gurten Papuli**, shtetase Shqiptar, lindur më 21/05/1986 në Tiranë, Shqipëri, me ID I60521085A, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKU THEMELUES

GURTEN PAPULI

GURTEN PAPULI

